

SPECIFIKIME TEKNIKE

KËMISHË ME MËNGË TË GJATA

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave të Policisë Bashkiake, me mëngë të gjata, me puplinë të tezgjahur, cilësi e parë.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike (këmishë nr. 41/42 dhe dy jaka të gatëshme) e prodhuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me 0.3ml gjatësi lëndë e parë (tekstil bojë qielli) dhe sa vetë gjerësia e tekstilit. Të dy anët e tekstilit të janë të myllura në formë të rregullt.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve do të shërbejnë si bazë për prodhim .

Mostrat duhet të jenë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e këmishave:

- Puplinë cilësi e parë, bojqelli, tekstil i tezgjahur, me përzjerje 33% pamb.dhe 67% poliest.(± 3%).
 - Fortesë mansheti për mëngët me kollaritje të plotë.
 - Prodhohen me jakë të myllur.
 - Numuri i fillit : në bazë 75/1-80/1;në ind 75/1-80/1.
 - Numurat e gjoksit 7, nga $44 \div 56$.
 - Dëndësia në 10 cm: në bazë 450 ± 10 ; në ind 300 ± 10 .
 - Pesha : = 108 ± 3 gr. – Thurje garniturë.
 - Qëndrueshmëria (kg) : 70 –6 ; në ind 40 – 6.
 - Penj qepje 100 % poliestër me ngjyrën e tekstilit ose ngjyrë tjetër me ndryshim të pa përfilshëm.
 - Numurat e jakës:36,37-38,39-40,41-42,43-44,45-46,47-48,49-50.
 - Frazelinë me ngjitje për forcimin e spalinës, kapakëve të xhepave.
 - Në gjoks ka dy xhepa pllakë me muzhik, me kapak me përmasa 14×16 cm.
 - Kopsa të vogëla me ngjyrën e tekstilit ose të bardha të shndritshme me katër vrima. Kopsa të vogëla plastike ngjyrë argjëndi për xhepat dhe spalinat.
 - Në krahun e majtë, poshtë kokës së supit qepet shiriti hark me fushë bojëqelli, ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë “POLICIA BASHKIAKE” dhe nën të qepet stema e bashkisë.
 - Në gjoksin e djathtë, mbi qepjen e kapakut të xhepit, qepet bazament velkrofi 70×20 m/m për vendosjen e numurit personal.
 - Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës të lëndës së parë (puplinë bojë qelli)të jenë të qëndrueshme e shumë të qëndrueshme, nota 4 – 5 sipas S.SH.- 658/ 13- 88 .
 - Konsiderohen difikte të përrhapura të pamjes së jashtëme dhe nuk lejohen: papastërti me orgjinë bimore, njolla të ndryshme, spërkatje me vajra ose bojra,nuanca të ngjyrës, oksidime, palosje, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind, trashim i fijeve, lëkundje në gjerësi etj..
 - Mostrat e puplinës që shoqërojnë këmishët të jenë me gjatësi 600– 700m/m (S.SH.658-88).

Këmishat me mëngë të gjata prodhohen në këto përmasa(cm):

Emërtimi	Numurat e jakës								Devijimi ± 0.5
	36	37-38	39-40	41-42	43-44	45-46	47-48	49-50	
Gjatësia e këmishës	82	82	82	82	82	82	82	82	± 1.5
Gjatësia e mëngëve	62	62	62	62	62	62	62	62	± 1.0
Rrethi i gjoksit	52	54-56	57-58	60-62	64-66	66	68	70	± 1.5
Shpatullat	42	43-44	45	47-48.6	50-51.4	53-53.5	54	54.5	± 1.0
Vendosja e xhepit	7x23			8x23					

SPECIFIKIME TEKNIKE

KEMISHE ME MENGE TE SHKURTER

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave me mëngë të shkurtër për Policinë Bashkiake, me puplinë të tezgjahur, cilësi e parë, me përzierje 33% pambuk dhe 67% poliestër($\pm 3\%$).

Realizohen në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës(një këmishë me nr jake 41/42), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me një jakë dhe një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë të parë pëlhirë sintetike me gjerësinë e vet tekstit.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktiveve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostrat e sjella duhet të janë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhim:

- Puplina është në ngjyrë dhe me cilësi të njëjta me puplinën e këmishëve me mëngë të gjatë, penjtë për qepje etj.. - Jaka e myllur me kollaritje .
- Spalinave dhe kapakeve te xhepave u vendoset frazeline.
- Gjatësia e menges per prerjen e pare eshte 250 m/m, me rritje nga 10(dhjetë) m/m për çdo prerje, gjerësia 230 m/m.
- Qepja te bëhet me penjë 100% poliestër ne ngjyrën e këmishës me 25-30 shpime gjilpëre në 50 m/m gjatësi.
- Mëngët ne fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Mëngët ne fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Dy xhepa pllakë në gjoks, me përmasa: gjerësi x lartësi=140x160 m/m, me kapak(shih skicat).
- Kapakët e xhepave dhe spalinat mbërthehen me kopsa në ngjyrë argjëndi.
- Kapakët e xhepave, spalinat dhe menget (ne bashkim me trupin) te kene tegela nga jashtë me 3 – 4 hapa në 10 (dhjetë) m/m dhe me largesi nga buza 5 mm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje, me penj të bardhë “POLICIA BASHKIAKE” shiriti në formë harku me gjatësi: harku i sipërm 105 m/m, harku i poshtëm 80 m/m, gjerësia 25 m/m dhe fileto e kuqe në të gjithë gjatësinë e buzëve. Ky shirit qepet 15 m/m poshtë kokës së supit, simetrik me qepjen e spalinës. Poshtë shiritit 33 m/m qepet Stema e Bashkisë, simetrike me harkun e poshtëm.

Emërtimi	Numurat e jakës								Devijimi ± 0.5
	36	37-38	39-40	41-42	43-44	45-46	47-48	49-50	
Gjatësia e këmishës	82	82	82	82	82	82	82	82	± 1.5
Gjatësia e mëngëve	25	29	29	29	29	29	29	29	± 1.0
Rrethi i gjoksit	52	54-56	57-58	60-62	64-66	66	68	70	± 1.5
Shpatullat	42	43-44	45	47-48.6	50-51.4	53-53.5	54	54.5	± 1.0
Vendosja e xhepit	7x23			8x23					

SPECIFIKIME TEKNIKE

Këpucë gjysma (1/2) me lëkurë natyrale, boks viçi,

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve gjysma për Policinë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike, një palë këpucë nr. 41- 42, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me një pjesë 30 x 20 cm lëndë e parë, boks viçi + astar meshin viçi cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e këpucëve :

- Lëkurë me faqe natyrale, boks viçi ngjyrë e zezë. Lëkurët të jenë të shtrira mirë, të buta, të mbushura, të ngjeshura e kompakte.
- Astar meshin viçi, pa sharruar, me trashësi $0.9 \div 1.2$ mm për astar shtroje dhe pjesën e brëndëshme e përparme(astar faqe). Meshina me prekje me dorë të jetë e butë, e ngjeshur, e kompakte, e shtrirë, lejohet të ketë pak push. Meshina të ketë ngjyrë të njëllojtë në të gjithë siperfaqen dhe të qëndrueshme. Në astar faqja e brëndëshme e përparme etj.(pa astar shtroje) lejohet që meshina të jetë me trashësi $0.7 \div 0.9$ mm.
- Taban soleti (lëkurë natyrale), me trashësi $2 \div 3$ mm. Tabanit në pjesën e thembrës i vendoset një kamaretë (shirit çeliku) të kanalizuara me vraturë të përmasave: gjatësia $80 \div 85$ mm gjerësia $8 \div 10$ mm dhe trashësi $1 \div 1.2$ mm.
- Penj sintetik mbi 9 kg, nr. 40/3 dhe 30/3 për qepjen e veshëve, prapshtina, filetat dhe tegelat etj.
- Gjerësia e pjesës së mbyllur të faqes së makinës dy gjylpërësh të ketë distancë $1.5 \div 2$ mm.
- Tegeli duhet të jetë $1 \div 1.5$ mm largë buzëve dhe të ketë 3-4 hapa në 10 mm në lapetë dhe në rrumbullaksinë e theksuar ku uniformiteti nuk ruhet. Në mbylljen e syprinës, bëhet përforcimi me tegela dopio.
- Bombé termoplastike në pjesën e majës të këpucës.
- Forté termoplastike ose kartoni të presuar, i posaçëm që nuk thyhet, i lyer me solucion kundra ujit (që nuk thith ujë).
- Shollë gome të presuar, nga poshtë me lule e kanale, me thellësi $4 \div 5$ mm. Taka e këpucës bashkë me kanalet e poshtëme të jetë me lartësi $22 \div 23$ mm, ndërsa bashkë me fjapën do të jetë me lartësi $28 \div 30$ mm. Taka të jetë unike, një trup me shollën e gomës.
- Ngjitës me një komponent për ngjitjen e fjapës me tabanin dhe me dy komponentë për ngjitjen e fjapës me shollën e gomës. Rezistenca e ngjitjes së fjapës me tabanin dhe e fjapës me shollën të jetë shumë e mirë.
- Me katër vrima në të dy anët, pa syza, për kalimin e lidhësave .
- Lidhësat të jenë të zeza, të rrumbullakta, prej fije teritali e poliestre deri 600 mm gjatësi.
- Maja e këpucës të jetë karé (gjysëm katorri), në formë harku të lehtë në të dy këndet.
- Lartësia e qafës së këpucës (duke ju referuar nr. 41) e matur nga jashtë mbi xhiron e gomës të jetë 65 ± 1 mm, ndërsa e matur nga brënda mbi astarin shtroje të jetë 58 ± 1 mm.
- Në pjesën e sipërme prapa qafës së këpucës, vendoset sfungjer me gjerësi 15 mm dhe gjatësi $250 \div 275$ mm në varësi të numurit.

KARAKTERISTIKAT FIZIKO – MEKANIKE – KIMIKE

E LEKUREVE NATYRALE (Boks viçi) PER KEPUCE GJYSMA (1/2)

PER POLICINE BASHKIAKE

(S.SH. -1143 – 89)

- Trashësia: 1.1÷1.4mm
- Yndyra në %: 4 ÷ 7
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes, 10 Mp (kg/mm^2) : 1.8
- Rezistenca ndaj këputjes së faqes: 2.0
- Qëndrueshmëria deri në këputje në %: 40÷60
- Penetrimi i ujit në jo më pak se: 40' (dyzetë minuta)

SHOLLE GOME E FJAPE GOME TE PRESUAR

(S.SH. – 2638 – 87)

- Fortësia në gradë shore: 75 ± 3

SPECIFIKIME TEKNIKE

PER KEPUCE ME QAFA, TRUPE, ME LEKURE NATYRALE

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve me qafa, trupe për Policinë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike, një palë këpucë nr. 41-42, të ndërtuara me materialet e poshëshënuara, të shoqëruar me një pjesë lëndë e parë 30×20 cm, vaqet cilësi e parë + astar meshin dhije cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktiveve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhim :

- Faqe natyrale (vaqetë) cilësi e parë, kromato, tip " U ".
- Astar meshin dhije $0,9 \div 1,1$ m/m për të gjitha pjesët e brëndëshme. Lejohet me trashësi $0,7 \div 0,9$ m/m në faqet e brëndëshme e të përparme .
- Taban soleti (lëkurë natyrale).
- Kamaretë çeliku e mbuluar me kartonfibër të presuar.
- Penj sintetik mbi 9 kg. nr. 40/3 – 30/3 për qepjen e syprinës. - Mbyllja e syprinës me tegela dopio ose 4 copë butona për palë.
- Bombë termoplastike për pjesën e majës.
- Fortesë termoplastike ose karton i presuar i posaçëm për prapshtinën.
- Fjapë gome të presuar me trashësi $2,8 \div 3,0$ mm.
- Xhiro gome të presuar, trashësia $2,8 \div 3,0$ mm.
- Shollë gome të presuar (nga poshtë me llokma të dhëmbëzuara). Trashësia pa llokma: $7 \div 8$ mm, me llokma: $17 \div 18$ mm.
- Taka e këpucës me llokmën, lartësia $25 \div 26$ mm, ndërsa bashkë me hapsirën që shoqërohet me xhiron e gomës, lartësinë e takës do të jetë 32 ± 1 m/m.
- Penj sintetik fill 1 m/m me rezistencë 38 kg për qepjen e fjapës me tabanin.
- Ngjitës me një komponent për ngjitjen e fjapës me tabanin.
- Ngjitës me dy komponent për ngjitjen e fjapës me gomën (shollën).
- Me katër vrima me size në fillim në të dy anët e në vazhdim të vrimave gjashtë kapse në formë gonxhe ose fisash për kalimin e lidhsave në formë kordoni.
- Lartësia e qafës së këpucës 230 ± 2 m/m mbi xhiron e gomës.
- Në mbyllje te lartësisë midis kapses 8 dhe 9 deri tek kapsja e 10 (sa gjeresia e tyre) nga 20 m/m larg buzeve (vize ose gonxhe) vendoset sfungjer midis astarit dhe lekures dhe e qepur brenda jashte me penje sintetik.
- Semenza makine me gjatësi $8 \div 9$ m/m për mbërthim të faqes së këpucës me tabanin në pjesën e prapme .
- Në lapetë mbi kurrizin e këmbës në gjerësinë 30 m/m dhe 40 m/m poshtë përfundimit të lapetës vendoset sfungjer midis astarit dhe lëkurës të qepur brënda jashtë me penj sintetik.
- Etj.

KARAKTERISTIKAT FIZIKO – MEKANIKE – KIMIKE

**TE LEKUREVE NATYRALE (VAQETE TIP “U”) PER KEPUCE
ME QAFA TRUPE (S SH 1143 – 89)**

- Trashësia	1.9 ÷ 2.5 mm
- Yndyra në %	8 ÷ 11 %
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes 10 Mpa (kg/mm ²)	1.6
- Rezistenca ndaj këputjes së faqes	2.0
- Qëndrueshmëria deri në këputje në %.	÷ 70
- Penetrimi i ujit, jo më pakë se:	240°(4 orë)

SHOLLE GOME DHE FJAPË GOME TE PRESUAR:

(S.SH. 2638 – 87) (S.SH. 2896 – 87)

- Fortësia (në gradë shores): Sholla	85 ± 3
Fjapa	75 ± 3

SPECIFIKIME TEKNIKE

Për kostum dok - terikoton

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kostumit dok-terikoton të policisë bashkiake.

Realizohen me tekstil të tezgjatur, në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike (1xhaketë, 1kapele, 1palë pantallona), numur gjoksi 54; gjatësi trupore $173 \div 178$ cm (prerja IV), kapele nr.56, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë lëndë e parë 0.3 ml gjatësi dhe sa gjerësia e tekstit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktiveve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e kostumeve:

- Dok terikoton blu i errët, cilësi e parë, përzjerje 67% poliestër me 33% pambuk($\pm 3\%$);
- Pesha për $m^2 = 260 \pm 5$ gr. - Thurje = sarzh 3/1. - Numri i fillit: Në bazë e ind = $35/1 \pm 3$;
- Dëndësia në 10 cm : a) Në bazë 470 ± 6 ; b) Në ind 210 ± 6 ;
- Qëndrueshmëria kg : a) Në bazë = $153 - 6$; b) Në ind = $60 - 6$. - Frazelinë (fortësë).
- Shirit fosforeshent në ngjyrë argjëndi për në shpinë të xhaketës me gjerësi 30 m/m..
- Astar xhepi tekstil, 100% viskoz dhe qemer i përgatitur për pantallonat.
- Ekstrafor, zinxhir konfekzioni 22 – 24 cm me dhëmbë plastik për pantallonat ;
- Penj qepje blu 80/2 , qepje industriale 100% poliestër . - Perçinat me tel sustë.
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës të lëndës së parë të jetë nota 4 – 5 (SSH 658 – 88).

Xhaketa me jakë sport, me spaleta, me dy xhepa pllakë me kapak në gjoks, me llastik të gjerë në bel. Mansheti i mëngës me bishtok për mbërthim me perçinë. Supet dhe brylat të përforcuara. Në krahun e majtë, poshtë kokës së supit, qepen shënjet dalluese. Mbi xhepin e djathë, në gjoks qepet velkrof për numurin personal.

Pantalloat me dy xhepa para, të brëndshëm, me kapak; me dy xhepa anësor (pllakë); me përforcime tek gjunjët; me llastik të gjerë për tek shputa e këmbës; një xhep prapa të brëndshëm (120x150 mm) që mbërthehet me peçinë.

Kapela sportive, me strehë të gjatë plastike e veshur me dokun e vet, me përforcim në kupë, me rrip prapa për rregullimin e gjerësisë, në ballë shkruar me qëndisje me penj të bardhë në formë harku "POLICIA BASHKIAKE" dhe poshtë qepet stema e Bashkisë.

Pantallonat prodhohen në gjatësitë dhe prerjet e poshtëshënuara:

Gjatësia e trupit (në cm)	Gjat. e pantalonit (cm)	Prerja
155-160	93	parë
161-166	97	dytë
167-172	100	tretë
173-178	103	katërt
179-184	106	pestë
185-190	110	gjashtë

Xhaketat prodhohen në përmasat e poshtëshënuara :

Emertimi	Numurat e jakes												Devijimi		
	36	37	38	39-40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	0.5
Gjat. e xhaketës	82	82	82	82	82	82	82	82	82	82	82	82	82	82	1.5
Gjat. e menges	62	62	62	62	62	62	62	62	62	62	62	62	62	62	1.0
Rrethi i gjoksit	52	54	56	58	60	62	64	66	66	66	68	68	70	70	1.5
Shpatulla	42	43	44.4	45.8	47.2	48.6	50	51.4	52.8	53.5	54	54	54	54.5	1.0

SPECIFIKIME TEKNIKE

KOSTUM TERITALI, BLU

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kostumeve blu të Policisë Bashkiake.

Realizohen me tekstil të tezgjahur në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike (1xhaketë, 1 kapele, 1palë pantallona), numër gjoksi 54; gjatësi trupore $173 \div 178$ cm (prerja IV), kapele nr.56, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë e parë (stof blu) dhe sa gjerësia e tekstit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktiveve do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e kostumeve:

- Stof ngjyrë blu i errët, cilësi e parë me përzjerje 45 % lesh dhe 55% poliestër ($\pm 3\%$);
- Numri i fillit: a) Në bazë = 40/2, 42/2; b) Në ind = 40/2, 42/2;
- Dëndësia në 10 cm: a) Në bazë = 310 ± 10 ; b) Në ind = 260 ± 10 ;
- Qëndrueshmëria kg: a) Në bazë = 90-6; b) Në ind = 80-6;
- Astar mëndafshi importi(blu e errët ose e zezë) 100% poliestër.
- Merle (material ngjitetë special dhe i përshtatshëm për pjesën e gjoksit),100% poliestër.
- Frazelinë (material ngjitetë për xhaketën dhe pantallonat).
- Astar xhepi, tekstil 100% viskoz. – Vata (jo pambuku) të posaçme për kostum burri.
- Penj qepje blu 80/2, qepje industriale 100% poliestër. - Thurje = sarzh.
- Kopsa të vogëla e të mëdha, ngjyrë argjendi. Fusha e kopsës të jetë e pastër, pa relieve e konfiguracione të ndryshme brënda. - Kanavacë importi , 100% lesh.
- Stof leshi me ngjyrë të përshtatshëm për pjesën e nëntëshme të jakës së xhaketës.
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave nota 4 – 5. - Pesha për m^2 = 290 ± 10 gr.
- **Xhaketa** monopet, me katër kopsa të mëdha para, me prerje hark nga shpatulla deri në fund, me çarje prapa. Me dy xhepa pllakë poshtë (180 x 210 mm) me kapak dhe lartë (140 x 160 mm). Xhepat kanë muzhikë vertikal. Mbi xhepin e djathtë qepet velkrof për numurin personal dhe në krahun e majtë, poshtë kokës së supit qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë " POLICIA BASHKIAKE " dhe nën të stema e Bashkisë. Spaletat me përmasa: 50 x130 mm, me fileto të kuqe anash, mbërthehen me kopsë metalike ngjyrë argjendi. Dy xhepa të brëndshëm që mbërthehen me kopsë ebaniti ngjyrë e zezë.
- **Pantallonat** kanë dy xhepa anësor me prerje diagonale dhe një xhep prapa (120 x 150 m/m), pa kapak, mbërthehet me kopsë ebaniti. Kanë nga dy pensa në të dy anët. Zinxhir konfekzioni për mbërthimin e pantallonave, me dhëmbë plastik. Kapse metalike mashkull – femër për mbylljen e pantalonave dhe bishtok. Qemer i përgatitur për pantalonat. Shtatë vega për kalimin e rripit 50 mm të gjerë.

Kostumet prodhohen në gjatësitë dhe prerjet e poshtëshënuara:

Gjatësia e trupit	Gjat. e xhaketës	Gjat. e pantalonit	Prerja
155-160	70	93	parë
161-166	73	97	dytë
167-172	76	100	tretë
173-178	79	103	katërt
179-184	82	106	pestë
185-190	85	110	gjashtë

SPECIFIKIME TEKNIKE

KAPELE

PER KOSTUM TERITALI BLU

- Modeli-tip oficeri .
- Ka formë vezake.
- Materiali dhe ngjyra si e kostumit.
- Prodhohet në dhjetë numëra (53 ÷ 62). Numuri përfaqëson perimetrin e kokës.
- Strehë plastike (të mos deformohet nga ndryshimi i temperaturës së ajrit), me shkëlqim nga sipër, me gjëresi në qëndër 50 mm, në ngjyrë të zezë, me astar.
- Nga brënda kapelja ka astar mëndafshi, dhe rrëth tepelekut (nga brënda) ka të qepur një shirit lëkure me gjëresi 5 cm.
- Për të ruajtur formën, nga brënda vendoset një fletë çeliku 5 mm e gjerë me fortësi deri 60 mangan.
- Mbi strehë vendoset një shirit plastik i zi (për inspektorët ngjyrë argjëndi) me shkëlqim, me gjëresi 15 m/m dhe mbërthehet anash me dy kopsa të vogëla metalike në ngjyrë argjëndi.
- Në ballë vendoset stema e Bashkisë me përmasa: 50 m/m gjatësi e 34 m/m gjëresi.

Legjenda:

A –lartësia e rrëthit të kapeles sipas perimetrit të kokës.

B –gjerësia e urave përpara.

C –gjerësia e urave prapa (shënim: urat përpara dhe prapa janë të përforcuara me fortesë të kollaritur).

D –gjatësia e tepelekut të kapeles.

E –gjerësia e tepelekut të kapeles.

F –përmasat e rrëthit plastik në tepelek.

Përmasat e detajuara të kapeles (në m/m):

Nr.	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62
A	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
B	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
C	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
D	28	28.5	29	29.5	30	30.5	31	31.5	32	32.5
E	24	24.5	25	25.5	26	26.5	27	27.5	28	28.5
F	74	75	76	77.5	79	81	83	85	87	89

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KRAVATA

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kravatave të Policisë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike (një kravatë) të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë të parë pëlhirë sintetike dhe sa gjerësia e tekstilit.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Materialet që do të përdoren:

- Materiali cilësi e parë, pëlhirë sintetike, 100 % poliestër.
- Ngjyra blu e errët.
- Gjatësia 500 ± 20 mm ;
- GJerësia 45 ± 5 m/m në fillim (koka) e 80 ± 5 m/m në fund.
- Me astar mëndafshi, importi,(blu i errët ose i zi),100% poliestër.
- Frazelinë për fortesë nga brënda.
- E lidhur në formë koke dhe në fund të jetë në formë trekëndëshi dybrinjëshëm.
- Me llistik të gjerë 15 m/m që kalon dhe fiksohet brënda kokës, dhe në të dy anët e llistikut qepet velkrof për t'u mbërthyer në qafë me gjatësi 40 deeri 50 m/m..
- Pesha e pëlhirës sintetike 190 ± 5 gr/m².

SPECIFIKIME TEKNIKE

PANTALLONA TERITALI , VERE

Këto specifikime përcaktojnë kërkesat cilësore për prodhimin e pantallonave të verës të Policisë Bashkiake me tekstil të tezgjahur, ngjyrë blu i errët, cilësi e parë.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike (një palë pantallona vere, numur gjoksi 54 (173 -178 cm, prerja e katërt), të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me një pjesë lëndë e parë me gjatësi 0.3 ml (tekstil blu i errët) dhe gjerësi sa vetë tekstili.

Mostra e sjellë nga prodhuesi dhe të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas kërkesave do të shërbejë si bazë për prodhimin e pantallonave.

Konsiderohen difikte të përhapura të pamjes së jashtëme dhe nuk lejohen papastërti me orgjinë bimore, njolla të ndryshme, nuanca të ndryshme të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind, trashim filli, lëkundje në gjerësi etj(S.SH.1038-88).

Ngjyra e mostrës do ti nënështrohet provës si ndaj(fërkimit të thatë, të njomë, në larje solucioni, sapune, djersë, etj.) dhe nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituara. Copa e bardhë që do të shoqërojë mostrën pothuajse nuk ndotet, mbetet pa ndotur, (S.SH. 658-88).

Mostra e sjellë duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren per prodhimin e pantalonave të verës:

- Stof blu i errët, cilësi e parë, i tezgjahur me përzjerje 35%viskoz dhe 65% poliestër ($\pm 3\%$).
- Pesha për m^2 : 210 ± 5 gr. – Thurje = sarzh 2/1. – Frazelinë (material ngjitës).
- Numuri i fillit: në bazë = $45/2 \pm 3$; në ind = $52/1 \pm 3$.
- Dëndësia për 10 cm: në bazë = 340 ± 6 ; në ind = 265 ± 6 .
- Qëndrueshmëria (kg): në bazë = $153 - 6$; në ind = $70 - 6$.
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 – 5 .
- Astar xhepi dhe qemeri, tekstil 100% viskoz.
- Penj qepje blu 80/2, 100% poliestër ; qepje industriale.
- Zinxhir plastik konfeksioni 22÷24cm, kapse metalike (femër-mashkull), bishtok për mbërthimin e pantalonave.
- Përpara ka katër pensa (dy në çdo anë) me thellësi 12 deri 15 m/m.
- Me dy xhepa anësor me prerje diagonale, një xhep prapa –djathtas me përmasa $120x150$ m/m, mbërthimi me kopsë ebaniti të zezë me katër vrima.
- Qemer i përgatitur për pantalonat. Shtatë vega me gjatësi 50 m/m për kalimin e rripit të pantalonave.

Pantallonat prodhohen në gjatësi, gjatësi trupi si më poshtë :

Gjatësia e trupit	Gjatësia e pantalonave	Prerja
155 – 160	93	parë
161 – 166	97	dytë
167 – 172	100	tretë
173 – 178	103	katërt
179 – 184	106	pestë
185 – 190	110	gjashtë

SPECIFIKIME TEKNIKE

PULOVRA

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të pulovrës së Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes eë jashtëme të mostrës fizike (një pulovër nr. gjoksi 54/4,gjatësi trupore 173-178), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktiveve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e pulovrës :

- Fill, cilësi e parë, me përzjerje 50 % akrilik + 50% lesh . – Pesa = 600 ± 10 gr.
- Ngjyrë blu e errët.- Punim i thjeshtë.- Numuri i fillit 40/2 – 42/2.
- Dok terikoton blu me përzjerje pambuk e poliestër për përforcimet e supeve e të brylave.
- Frazelinë (fortesë) për përforcimin e spaletës. – Në gjoksin e djathtë vendoset velkrof për bazamentin e numurit personal me përmasat 75 x 20 m/m..
- Vlerat e qëndrueshmërisë së ngjyrave të lëndës së parë (fill blu), të jenë të qëndrueshme e shumë të qëndrueshme (nota 4 – 5). Ngjyra e mostrës që do t'i nënështrohet provës në qëndrueshmëri të ndryshme(si ndaj fërkimit të thatë,të njomë,në larje solucioni,sapun e djersë,etj.) nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituar. Copa e bardhë që do të shoqërojë mostrën në provë nuk duhet të ndotet,(S.SH.-658 – 88).
- Jaka në formë v-je, llastiku me gjerësi 30 m/m. – Mbyllja e mëngëve dhe e fundit të trupit me llistik me gjerësi 50 m/m.
- Në krahun e majtë, 15m / m poshtë kokës së supit qepet shiriti në formë harku ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë”POLICIA BASHKIAKE” dhe poshtë tij stema e bashkisë e vendosur mbi një katërkënnësh doku vertical që ka një xhep.
- Spaletat, dok i plastifikuar me gjerësi 45 m/m dhe gjatësi sipas numurave, që mbërthehen me kopsa të vogëla plastike, në ngjyrë argjendi.
- Në lëndën e parë (fill blu) cilësia e parë që do të përdoret për prodhimin e pulovrave të Policisë Bashkiake, konsiderohen difekte të pamjes së jashtëme dhe nuk lejohen : papastërti me orgjinë bimore, njolla të ndryshme, spërkatje me vajra ose bojra, nuanca të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind apo trashim i tyre, luhatje në gjerësi etj, S.SH.1038 – 88).

Përmasat e pulovrës

Gjatësia e trupit(cm)	Gjatësia e pulovrës(cm)	Prerja
155 – 160	66	parë
161 - 166	68	dytë
167 – 172	70	tretë
173 – 178	72	katërt
179 – 184	74	pestë
185 – 190	76	gjashtë

Prerja e katërt :gjerësia e shpinës 47 cm;gjerësia e gjoksit 54 cm.;gjerësia në fund 38.5cm;gjatësia e mëngës nga qepja me supin e deri në fund 62 cm,etj.

SPECIFIKIME TEKNIKE

RRIP LEKURE, TELATINE, I ZI PER PANTOLLONA

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të rripit të pantallonave për Policinë Bashkiake, me lëkurë telatinë, cilësi e parë, me regjie gjysëm kromi.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike (1 rrip i kompletuar) dhe një pjesë lëndë e parë 20 x 30 cm.

Mostra e sjellë nga prodhuesi dhe e miratuar nga përdoruesi (porositësi), të dpozituar sipas përcaktiveve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e rripit :

- Lëkurë natyrale (telatinë) me regjie gjysëm kromi, ngjyrë e zezë.
- Trashësia e lëkurës 3.5 ± 0.1 mm.
- Gjatësia e rripit $1200 - 1350$ (± 20 m/m).
- Gjerësia e rripit 42 ± 1.0 m/m .
- Sipërfaqja e jashtëme të ketë uniformitet në ngjyrë dhe s'duhet të ketë shënja të ndryshme që e dëmtojnë .
- Tokëz metalike sipas modelit dhe përmasave me material bronx i kromuar, me derdhje, në sipërfaqe të ketë uniformitet, të mos ketë gropëzime e valëzime, me kromim rezistent.
- Rapide të vogëla metalike të kromuara.
- Ripi në pjesën e përparme ka 7 (shtatë) vrima me largësi 40 m/m nga njëra-tjetra . Ka vegën që realizohet me ngjitje rezistente me gjerësinë e skajimit të jetë 10 mm dhe pjesa e përfundimit të skajimit të jetë 2 mm.
- Vega me gjerësi 15 mm e gjatësi 50 mm.
- Lëkura (telatina) të jetë plotësisht në të gjithë sipërfaqen e prerjes së tërthortë dhe të ketë përkulshmëri.
- Lëkura (telatina) të jetë e vajosur, pa plasaritje dhe të ketë apreturim të mirë.
- Lëkura (telatina) të jetë e ngjeshur dhe kompakte, të ketë trashësi e gjerësi të barabartë në të gjithë sipërfaqen.
- Gjatë fërkimit në të thatë e në të njomë, pëlhura e bardhë e pambukut të mos ndotet nga boja që jan ngjyrosur lëkurët.

KARAKTERISTIKAT FIZIKO – MEKANIKO – KIMIKE të lëkurës.

(S.SH.: 1145 – 89)

- Yndyra në %.....8÷15
- Rezistenca ndaj plasjes, kg/m² në jo më pak se 10Mpa..... 2,0
- Rezistenca ndaj këputjes, kg/m² jo më pak se 10 Mpa..... 2,5
- Koeficienti i regjies: mirë, shumë mirë, e plotë, nuk tkurret.
- Zgjatimi deri në këputje etj.,sipas S.SH..
- Prova e regjies..... pozitive
- Prova e mosregjies..... negative

Bashkia e Tiranës
Policia Bashkiake

SPECIFIKIME TEKNIKE

RRIP SHERBIMI – SINTETIK, TRUPE

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Rripit të shërbimit, sintetik për Policinë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike, një rrip shërbimi, sintetik, trupe.

Mostra e ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, e sjellë nga prodhuesi dhe e miratuar nga përdoruesi (porositësi), e depozituar sipas përcaktiveve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Materialet që do të përdoren:

- Materiali tekstil – sintetik, cilësisë së parë, me thurje të dendur (nga tërheqja nuk zgjatohet).
- Astar velkrofi në gjysmën e gjatësisë fundore.
- Ngjyra : blu i errët ose i zi.
- Gjatësia e përgjithëshme: 1350 (± 10 m / m).
- Gjerësia : $55 \div 60$ m/m.
- Tokëza për mbërthim : femër – mashkull (metalike e kromuar ose plastike) në ngjyrë blu ose të zezë.
- Vega : dy copë të futura në rrip, me gjerësi 15 m/m, me material metalik i kromuar ose sintetik të thurur.
- Këllëf për mbajtjen e pistoletës.
- Këllëf për mbajtjen e prangave (hekurave lidhës).
- Unazë për mbajtjen e shkopit të gomës.

Bashkia e Tiranës
Policia Bashkiake

SPECIFIKIME
DHE KËRKESA TEKNIKE
SPAleta (E heqëshme, në formë këllëfi)

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të spaletave të heqëshme për Policinë Bashkiake, të realizuara në linjë industriale, në mbështetje të mostrës fizike, një palë spaleta.

Mostra e ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, e sjellë nga prodhuesi dhe e miratuar nga përdoruesi (porositësi), e depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Materialet që do të përdoren:

- Dok i cilësisë së parë, i plastifikuar;
- Pesha : 120 ± 5 gr / m²;
- Ngjyra blu e errët;
- Përmasat : gjatësia në mes=95m/m; gjerësia në të dy daljet është përkatësisht: 50m/m dhe 58m/m.
- Gjithë konturet e spaletës janë me një fileto plastike të kuqe me gjerësi 3 m / m.

SPECIFIKIME TEKNIKE

XHUP OPERACIONAL

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit Operacional, të policisë bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike (1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore $170 \div 172$ cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0, 3 ml gjatësi lëndë e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstitilit. Të dy anët e tekstitilit të janë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktiveve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e Xhupit (xhakaventos):

- Material sintetik, 100% poliamid, kundra ujit, cilësi e parë, = $165 \text{ gr} / \text{m}^2$.
- Ngjyra blu e errët. - Thurje: Sarzh.
- Poshtë astarit vendoset vatinë = $120 \pm 5 \text{ gr} / \text{m}^2$.
- Astar mëndafshi importi (blu i errët ose i zi), 100 % poliestër, qepur në formë rombi.
- Pesha e astarit për m^2 = $125 \pm 5 \text{ gr}$.
- Numuri i fijeve si në bazë e ind (për 10 cm) do të jetë 340 ± 10 fije .
- Qëndrueshmëria (kg) në bazë = 95 ± 5 ; ndërsa në ind = 90 ± 5 .
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5.
- Një xhep në gjoksin e majtë, i brendshëm, me kapak të madh (shih skicën) nga jashtë që mbërthehet me Zinxhir konfekzioni plastik, një xhep i brendshëm në anën e djathë që mbërthehet me kopsë ebaniti dhe dy xhepa përpara – poshtë me prerje diagonale.
- Mbërthimi para i xhupit, me zinxhir konfekzioni me dhëmbë plastikë dhe 3 perçina (me sustë).
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliestër.
- Mëngët, tek dora kanë bishtok dhe mbërthehen me perçinë, po kështu mbërthehen dhe spaletat.
- Jaka me stof ngjyrë e zezë.
- Me kapuç fëshfëshe që mblidhet prapa jakës.
- Fashë fosforeshente, ngjyrë argjëndi me gjerësi 30 m/m në shpinë dhe në gjoksin e djathë.
- Prodhohet në përmasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .
- Gjatësia për madhësinë XL = 86 cm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë " POLICIA BASHKIAKE " dhe nën të qepet Stema e Bashkisë. Fusha e harkut dhe e stemës është në ngjyrë blu të hapur dhe anash me një kornizë (imitim thurje) me qëndisje me penj të kuq.
- Në anën e djathë të gjoksit mbi fashë qepet bazament velkrofi për numurin personal.

SPECIFIKIME TEKNIKE

XHUP SINTETIK (xhakavento) - Kundra shiut

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit sintetik të policisë bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike (1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore $170 \div 172$ cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0,3 ml gjatësi lëndë e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstilit. Të dy anët e tekstilit të janë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktiveve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e Xhupit (xhakaventos):

- Material sintetik, 100% poliamid, i papërshkueshëm nga uji, cilësi e parë.
- Pesha e materialit poliamid = $165 \text{ gr} / \text{m}^2$.
- Dy shtresa gomimi e dy shtresa akrilik. - Thurje garniturë.
- Poshtë astarit vendoset vatinë = $120 \pm 5 \text{ gr} / \text{m}^2$.
- Astar mëndafshi importi (blu i errët ose i zi), 100 % poliestër, qepur në formë rombi.
- Pesha e astarit për m^2 = $125 \pm 5 \text{ gr}$.
- Numuri i fijeve si në bazë e ind (për 10 cm) do të jetë 340 ± 10 fije .
- Qëndrueshmëria (kg) në bazë = 95 ± 5 ; ndërsa në ind = 90 ± 5 .
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Një xhep në gjoksin e majtë, i brendshëm, me kapak nga jashtë që mbërthehet me perçinë, një xhep i brendshëm në anën e djathtë që mbërthehet me kopsë ebaniti dhe dy xhepa përpara – poshtë me prerje diagonale.
- Mbërrthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastikë dhe 3 perçina (me sustë).
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliestër.
- Mëngët, tek dora kanë llastik, por dhe rrip që mbërthehet me perçinë, po kështu mbërthehen dhe spaletat.
- Ngjyra blu e errët. Jaka me stof ngjyrë e zezë. Me kapuç fëshfëshe që mblidhet prapa jakës.
- Fashë fosforeshente, ngjyrë argjëndi me gjerësi 30 m/m në shpinë, gjoksin e djathtë dhe 20 m/m tek rripi i mëngëve.
- Prodhohet në përmasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .
- Gjatësia për madhësinë XL = 86 cm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë " POLICIA BASHKIAKE " dhe nën të qepet Stema e Bashkisë. Fusha e harkut dhe e stemës është në ngjyrë blu të hapur dhe anash me një kornizë (imitim thurje) me qëndisje me penj të kuq.
- Në gjoksin e djathtë mbi fashë qepet bazament velkrofi për numurin personal.